

që kanë siguruar shtëpi në vende të tjera ashtu edhe për familjet që ende nuk kanë shtëpi të tyre, ekziston vetëm një dëshirë kthimi në Mjak, pasi aty e kanë tokën dhe pasurinë”, ka thënë Beqiri. Ai ka theksuar se kthimi në Mjak, është i pamundur, pasi të gjitha shtëpitë janë të shkatërruara, nuk ka rrymë, shkollë e mbi të gjitha rruga për në fshat është e pakalueshme. “Janë 20 familje që janë shprehur se me rregullimin e rrugës dhe me pak ndihmë për të ndërtuar shtëpitë mund të kthehen në fshat, por askush deri më tani nuk na ka ndihmuar”, ka thënë Beqiri. Ai ka theksuar se dëshira për t’u kthyer lidhet edhe me gjendjen e rëndë sociale në të cilat jetojnë shumica e familjeve nga ky lokalitet, pasi ata sa kanë jetuar në Mjak, veprimtari kryesore për jetesë kanë pasur bujqësinë dhe blegtorinë.

“Familja ime ka pasur katër hektarë tokë pune, me të cilat kemi jet-

ndërtimi i shtëpive të ndërtuara gjatë luftës, asnjë veprimtari nuk është ndërmarrë që nga ajo kohë

uar, kurse tani jemi të detyruar që të punojmë punë të tjera vetëm për bukë të gojës”, ka thënë Beqiri. Edhe Mifail Metallari, banor i Mjakut që jeton në Viti, shprehet i brengosur se nuk po ka mundësi të kthehet në fshat shkaku i rrugës dhe i mungesës së shtëpisë.

“Kam rreth 100 krerë dele me të cilat siguroj mbijetesën e familjes, dhe ato në vend se ti mbajë në fshatin ku kam lindur e ku ekzistojnë kushte ideale për blegtori, jam i detyruar t’i mbajë këtu në Viti”, ka thënë Metallari. Ai ka theksuar se disa herë ka shkuar në komunë dhe ka kërkuar që së paku të ndihmohet fshati me rregullimin e rrugës nga Debelldehu deri në Mjak, por këto kërkesa nuk i ka marrë askush pasyrsh.

“Si banor dhe votues në këtë komunë, disa herë kemi shkuar tek

drejtuesit e komunës dhe kemi kërkuar ndihmë, por fatkeqësisht askush nuk është interesuar që të na përkrahë që të kthehemi në fshatin tonë”, ka thënë Metallari.

Nga ana tjetër, sipas drejtuesve të Komunës së Vitisë, buxheti i limituar i Komunës ka bërë që ky fshat mos të gjejë përkrahje.

“I dimë problemet e fshatit Mjak, por pos që pak kemi pas kërkesa nga banorët e këtij fshati që të kthehen, kemi një buxhet të limituar që të përbushim nevojat që ka ky lokalitet për t’u rindërtuar”, ka thënë Islam Jashari, drejtor komunal për ekonomi. Ai ka theksuar se për të mbështetur fshatin Mjak duhet edhe mbështetja e institucioneve qendrore, pasi aty krahas rrugës duhet ndërtuar komplet edhe infrastruktura tjetër e nevojshme për jetë në këtë lokalitet.

Transparencë dhe llogaridhënie minimale në institucionet lokale

Arian Duriqi

LIPJAN, 24 SHKURT – Sefer Tasholli, këshilltar nga Dega e LDK-së në Lipjan, ka qenë i vetmi opozitar që ka dalë përballë kryetarit të kësaj komune, Shukri Buja, në një debat për transparencën dhe llogaridhënien. Debatin e ka organizuar në fundjavë Asociacioni Rinor për Drejtat e Njeriut (YAHR) me temën “Transparenca dhe llogaridhënia e institucioneve lokale”, ndërsa në të ishin ftuar të gjithë përfaqësuesit e opozitës dhe të pozitës për të debatuar. Në takim, pos opozitarëve, ndërkaq, mungonte edhe kryesuesi i KK-së, Lulzim Rrustemi. Por takimin e kanë refuzuar edhe autoritetet komunale të Ferizajt, derisa Shtimja është përfaqësuar vetëm nga zyra e informacionit publik. Ndryshe, nikoqiri i takimit, Bekim Krasniqi, drejtor ekzekutiv në YAHR, ka deklaruar se, ndien keqardhje pse një numër i madh këshilltarësh opozitarë dhe të pozitës refuzuan debatën për një çështje të ndjeshme.

E për kreun komunal, takimet kësajsoj janë pozitive. “Pjesëmarrja në këtë debat do të duhej të ishte më ndryshe, sepse këto takime ndihmojnë jo vetëm për të shqyrtuar transparencën, por edhe për të operuar më mirë në Komunë”, ka thënë Buja. Duke folur për transparencën, kreu komunal ka thënë se gjatë vitit 2012 në adresë të komunës që drejton ka pasur 16 kërkesa për qasje në dokumentet zyrtare, ndërsa, sipas tij, në 12 sosh Komuna ka



dhënë përgjigjen, derisa 4 të tjera janë refuzuar për mos definimi të subjektit dhe adresim të gabuar. Mirëpo, sipas Bujës, e metë e qytetarëve mbetet mospjesëmarrja në debate publike, siç është diskutimi publik për buxhetin, rregulloret për planin zhvillimor etj. “Ende nuk e kemi identifikuar arsyen e mospjesëmarrjes së qytetarëve nëpër diskutime publike edhe pse kemi ndërmarrë hapa të nevojshëm për t’i informuar ata, nëpërmjet shpalljeve publike dhe faqes zyrtare”, ka thënë ai. Nga ana tjetër, Sefer Tasholli, sekretar në LDK, Dega e Lipjanit, ka shtruar nevojën e gjetjes së mekanizmave për të ardhur deri te një kontakt i qëndrueshëm

mes qytetarit dhe Komunës. Ndryshe, Tasholli, thotë se edhe këshilltarët nuk po i adresojnë si duhet kërkesat e tyre drejt ekzekutivit. “Shpesh këshilltarët nuk i ndjekin procedurat ligjore për të bërë kërkesë drejt ekzekutivit, por vetëm se ato i thonë gojarisht në mbledhjet e KK-së dhe kjo nuk është aq efikase”, ka thënë ai. Ndërkohë që, edhe Jetmir Bakija (KDI) ka kërkuar nga autoritetet komunale në Lipjan që ta gjejnë formën se si të njoftohen qytetarët qoftë për diskutime publike për buxhetin, qoftë për arsimin primar e për shëndetësinë, në mënyrë që pjesëmarrja e tyre të jetë në nivelin që kërkohet.

SKENDERAJ
tjika për nu
Klientët l
e nuk vjen
ilace”, është
shpesh kan
jse plotësis
mieret kan
60 klientë
shfrytëzoj
Nga insti
semurëve e
e shërbim
Shëndetës
Skenderaj
brenda 5-6
janë duke
të rregullt
ciale, ka tr
lidhur me
policinë ap
më shumë
marrë shë

Plehu

DRAGAS
se janë ng
Ata kan
që një gjë
drejtim të
erët me ja
Ylvi Qer
e ka bartu
syeshme
save të ba
paraqitur
cilave jar
“Ndoshta
për pastr
ngjet me
disa dhe
banor. Po
mbeturin
angazhua
me lagjet
mbeturin
tra që en
pohuar S

Kon

RAHOVEC,
hovecit është
nal prej n
avokatit, lë
konteste të
së Komunës
tyrës së avo
tori i Qendr
Bibli Oruçi
kaluar po e
Shefi i Zy
se Komuna
“Këtë pur
komunal. S
post do të j
risa të sqar
sipas nivelin
limit të Zyrë
Zyra e avok
duke punua
1975”, ka de
Sipas Hot